VENDIM
Nr. 422, datë 13.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 175, DATË 6.3.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT TË FIERIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "e", 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Lushnjë, Qarku Fier, bashkëlidhur vendimit nr. 175, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 4271 dhe nr. 4272, gjithsej 2 (dy) prona.

2. Pronat me nr. 4271 dhe nr. 4272, të llojit "truall", sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, kalojnë në pronësi të Bashkisë Lushnjë për t'u përdorur për ndërtimin e objekteve të sh.a., Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë.

3. Bashkisë Lushnjë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Lushnje

Fusha e perdorimit te Prones: Infrastrukture

Identifikoi: **Brunilda Bekaj Specialist**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: **Myftar Çela Specialist**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Fatos Tushe Kryetari I bashkise**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
4271	8572 Lu-M -6	14/58	Truall	Truall Lagja " Gafur Muco" Bashkia Lushnje	14850		Truall	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje	Nuk perfshihet pasuria 14/269 Truall+ndertese ne pronesi pri
4272	8572 Lu-M -6	14/57	Truall	Truall Lagja " Gafur Muco" Bashkia Lushnje	975		Truall	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje	

PLAN -VENDOSJA

E PASURISE NR 14/56 TE PRONARIT

Bashkia Lushnje. **QYTETI** Lushnje

SH 1:1000



KUFIZIMET :

V-14/53 **L-14/57,14/61,14/58**

J- 14/72,14/70+71,14/69,14/63,14/62,14/64+65 **P-14/55**

SPECIALISTI
Ing.KOSTANDIN PUKA
Ing.BRUNILDA BEKAJ

KRYETARI I BASHKISE
FATOS TUSHE

PLAN -VENDOSJA

E PASURISE NR 14/57 TE PRONARIT

Bashkia Lushnje. **QYTETI** Lushnje

SH 1:1000



KUFIZIMET :

V-14/58,14/56	**L-1461**
J- 14/61	**P-14/56**

SPECIALISTI
Ing.KOSTANDIN PUKA
Ing.BRUNILDA BEKAJ

KRYETARI I BASHKISE
FATOS TUSHE